



Përgjegjësit(ve)

Ref. jonë. Bdk/pla

Lozanë, dhjetor 2024

Regjistrimi i fëmijës suaj në vitin 1^{re} të shkollës së detyrueshme

Zonjë, Zotëri,

Fëmija juaj do të ketë moshën për të filluar shkollën në muajin gusht 2025. Sot po merrni një letër shpjeguese, një formular regjistrimi vetjak dhe një zarf për të na kthyer formularin e regjistrimit.

Kjo letër ju shpjegon se si ta regjistroni fëmijën tuaj në shkollë. Ajo gjendet në shqip, gjermanisht, anglisht, arabisht, kroatisht, spanjisht, italisht, portugalisht, serbisht e turqisht në lausanne.ch/entree-1P.

Shkolla publike është e detyrueshme dhe falas për të gjithë fëmijët që do të kenë mbushur 4 vjeç deri në 31 korrik 2024. Kjo parashikohet nga ligji kantonal mbi arsimin e detyrueshëm. Neni 54 i këtij ligji thotë : « Të gjithë prindërit me banim në kanton kanë të drejtën dhe detyrimin t'i regjistrojnë dhe dërgojnë fëmijët e tyre të moshës së shkollimit të detyrueshëm në një shkollë publike ose private, ose t'u japin mësim në banesë ».

Formulari i regjistrimit duhet të plotësohet dhe të dërgohet **para 10 janarit 2025**, me anën e zarfit bashkëngjitur.

1. Verifikoni informacionet dhe plotësoni formularin

Për të filluar, në pjesën « 1. Informacionet administrative »^[A1], të gjitha informacionet në ngjyrë gri duhet të plotësohen. Informacionet e tjera nuk janë të detyrueshme, por lehtësojnë komunikimin midis shkollës dhe juve.

Ju duhet të verifikoni që informacionet që kanë të bëjnë me fëmijën tuaj të jenë të sakta. Nëse ka informacione të pasakta, lutemi t'i korrigjoni.

2. Konfirmoni regjistrimin

Pastaj, ju mund të konfirmoni regjistrimin e fëmijës suaj në shkollën publike. Nëse nuk dëshironi ta regjistroni fëmijën tuaj në shkollën publike, ju duhet të saktësoni nëse fëmija juaj do të shkojë në shkollë private, në një institucion të specializuar apo do ta ndjekë shkollën në shtëpi. Nëse fëmija juaj nuk mund ta fillojë shkollën për arsye shëndetësore të rëndësishme, lutemi të bashkëngjisni një çertifikatë mjekësore.

3. Përcaktimi i vendit të shkollimit të fëmijës

Në pjesën « 3. Përcaktimi i vendit të shkollimit të fëmijës », informacionet na mundësojnë gjetjen e zgjidhjes sa më të mirë të mundur për fëmijën tuaj, pikërisht nëse ai ka vëllezër e motra në shkollën fillore, apo ka një vend në strukturën e pritjes ditore.

4. Datojeni dhe nënshkruajeni formularin

Formulari i regjistrimit, i datuar e i nënshkruar, përbën regjistrimin zyrtar të fëmijës suaj.

Faza e ardhshme

1. Seanca e informimit

Një seancë informimi organizohet **më 5 maj 2025**, në mbrëmje herët. Për këtë, do të merrni një letër.

2. Në cilën shkollë do të shkojë fëmija im ?

Në fund të muajit korrik, ne do t'ju dërgojmë një letër me emrin e shkollës, numrin e klasës dhe emrin e mësueses apo mësuesit të fëmijës suaj.

Oraret e shkollës dhe kujdestaria jashtë shkolle (parashkollore)

Në Lozanë, mësimi kryhet **çdo paradite nga ora 8.30 në 11.50** dhe nuk ka mësim pasdite për nxënësit e vitit të parë (1P).

Jashtë këtyre orareve, Qyteti ka krijuar struktura pritjeje parashkollore. Këto struktura nuk varen nga shkolla. Ato bëjnë pjesë në rrjetin e pritjes ditore lozaneze - Réseau-L. Ekzistojnë dy mundësi :

- **Fëmija juaj e ka një vend në një prej strukturave parashkollore të rrjetit - Réseau-L, dosja e tij do ta ndjekë atë** : ndërkaq prindërit duhet t'ia saktësojnë nevojat e tyre drejtorisë të strukturës së pritjes të tanishme.
- **Fëmija juaj nuk ka vend në rrjetin Réseau-L** : prindërit mund t'i drejtohen zyrës së informimit të prindërve (BIP) në numrin + 41 21 315 60 00 (lausanne.ch/bip).

Keni pyetje? Jemi në dispozicion ! Takim në sitin tonë të Internetit : lausanne.ch/scolarite ose na kontaktoni në numrin +41 21 315 64 11.

Në pritje të përgjigjes suaj, ju drejtojmë, Zonjë, Zotëri, përshëndetjet tona më të mira.

Shefja e shërbimit

Barbara de Kerchove

Shtojca : Formular regjistrimi dhe zarf me pullë

Kopje : Zonjave dhe Zotërinjve drejtoresha dhe drejtorë të institucioneve fillore lozaneze
Shërbimi i fëmijërisë